

VENDIM
Nr. 378, datë 6.5.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 418, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas ndarjes me emërtimin "Agjencia Kombëtare e Teknologjisë dhe Inovacionit" shtohet ndarja me emërtimin "Ministria e Zhvillimit Urban", sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Emërtimi "Komisioni i dhënies së licencave profesionale", në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëvendësohet me emërtimin "Komisioni i dhënies së licencave profesionale në fushën e zbatimit në ndërtim";

c) Emërtimi "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes" zëvendësohet me emërtimin "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes".

2. Në pikën 5, të vendimit, emërtimi "Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit" zëvendësohet me emërtimin "Ministria e Zhvillimit Urban".

3. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela

Institucioni buxhetor	Emërtesa e bordit/këshillit/komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Shpërblim kryetari (lekë)	Shpërblim anëtarë (lekë)
			Kryetari	Nr. i anëtarëve		
Ministria e Zhvillimit Urban	Komisioni i dhënies së licencave profesionale në fushën e studimit, të projektimit dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit	12	1	6	8.000	7.000
	Komisioni i dhënies së licencave profesionale në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme	12	1	6	8.000	7.000